

A mundet 2022 të ofrojë një fillim të ri?

Këshilli për Qeverisje Përfshirëse (CIG) organizoi me 11 shkurt 2022, në Tiranë, Shqipëri, tryezën e radhës për zyrtarë të lartë të partive politike nga Serbia dhe Kosova dhe një numër përfaqësuesish të shoqërisë civile. Pjesëmarrësit diskutuan se si ta bëjmë vitin 2022 vit dinamik në procesin e normalizimit. Mbajtur sipas rregullës të Chatham House, tryeza është pjesë e një projekti më të madh për normalizimin e marrëdhënieve Kosovë-Serbi të mbështetur nga Departamenti Federal i Punëve të Jashtme i Zvicrës (FDFA). Rekomadimet e raportit nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht pikëpamjet individuale të pjesëmarrësve, CIG ose FDFA, por bazohen në diskutimin në tërësi.

Pjesëmarrësit shprehën mbështetjen e tyre për procesin e normalizimit, megjithëse ishin skeptikë se një marrëveshje përfundimtare mund të arrihet së shpejti. Kishte konsensus se disa çështje mund të zgjidheshin drejtpërdrejt, pa i çuar në tryezën e bisedimeve në Bruksel. Kishte një dakordim të gjerë se BE dhe SHBA mund të përcaktojnë rrjedhën e dialogut. Pjesëmarrësit rekomanduan komunikim më të drejtpërdrejtë ndërmjet qeverive të Kosovës dhe Serbisë, rritje të bashkëpunimit në fushën e sigurisë dhe thjeshtim të procedurave për lëvizjen e lirë të njerëzve. Shumë thanë se Serbia dhe Kosova duhet gjithashtu të ndërtojnë njëfarë besimi përmes zbatimit të marrëveshjeve të nënshkruara. Ata duhet të tregojnë më shumë vullnet politik, koordinim më të mirë në dialog dhe të përmbahen nga retorika nxitëse.

Konkluzionet dhe rekomadimet

Beogradi dhe Prishtina duhet të 'ridizajnojnë' kornizën e dialogut. Prishtina dhe Beogradi kanë pikëpamje të kundërta për dialogun: përderisa Beogradi insiston se dialogu duhet të jetë një proces i sekuencuar që trajton çështjet e hapura në mënyrë progresive, Prishtina argumenton se zbatimi mund të jetë gradual, por vetë dialogu duhet të adresojë një "marrëveshje gjithëpërfshirëse të përqendruar në njohjen reciproke." "Dialogu deri tani ka qenë gradual dhe tani kemi një proces të zgjatur," argumentoi një folës. Kishte konsensus që palët të ishin më pragmatike dhe që korniza e dialogut të ridizajnohej. "Palët duhet të përpiqen ta vendosin veten në vendin e njëra-tjetrës." Prishtina dhe Beogradi sjellin shumë çështje në tryezën e bisedimeve, por asnjëra palë nuk është e gatshme për një kompromis. Disa thanë se çështjet që janë tashmë në tryezën e bisedimeve duhet të trajtohen përpara se të hapen çështje të reja. "Gjithashtu, Kosova dhe Serbia duhet të zhvillojnë diskutime të brendshme se si duan të duket marrëdhënia e tyre të ardhshme," shtoi një folës. Nëse Serbia nuk do ta njohë Kosovën së shpejti, duhet të përcaktohet modaliteti i një marrëveshjeje eventuale gjithëpërfshirëse që nuk përfshin njohjen. "Një marrëveshje që nuk përfshin njohje duhet të qartësojë se cilat elemente të shtetësisë së Kosovës njihen dhe cilat jo."

Ballkani i Hapur, iniciativë me mundësi dhe sfida. Beogradi dhe Prishtina kanë perspektiva të ndryshme për Ballkanin e Hapur: ndërsa Beogradi e sheh atë si një nismë rajonale që kryesisht "lidh ekonomitë", Prishtina e konsideron atë si "bashkëpunim rajonal ndërmjet shteteve" dhe ku "të gjitha shtetet duhet të trajtohen në mënyrë të barabartë." Përderisa disa besuan se Ballkani i Hapur mund të nxiste lëvizjen dhe tregtinë e lirë, të tjerë ishin skeptikë për këtë. Marrëveshja e

Tregtisë së Lirë të Evropës Qendrore (CEFTA) gjithashtu duket se ka disa kritikë. Një folës tha se CEFTA nuk e ka promovuar tregtinë e lirë aq sa pritej. Për të diskutuar mundësitë dhe sfidat e Ballkanit të Hapur, disa folës sugjeruan takime të drejtpërdrejta ndërmjet përfaqësuesve ekonomikë të Kosovës dhe Serbisë.

Marrëveshja për njohjen e diplomave nuk është zbatuar plotësisht. Marrëveshja për diploma është kthyer në një proces të stërzgjatur, ku disa universitete i kanë shtuar vështirësi një procesi tashmë të ndërlikuar. “Universiteti i Prishtinës” në Mitrovicën e Veriut mbetet çështja më e ndërlikuar. Prishtina ‘pranon’ por nuk i njeh diplomat dhe vetë universitetin. Shumë folës thanë se statusi i këtij universiteti duhet të rregullohet.

Narrativa ‘pajtuase’ dhe masat e ndërtimit të besimit janë thelbësore për një dialog të qëndrueshëm. Narrativa ‘jo-pajtuase’ po u serviren publikut të të dyja palëve. “Kosova duhet të ndryshojë paradigmen se si e percepton Serbinë dhe të përjashtojë idenë se mund të vazhdojë të jetë “mirë” pa njohjen e Serbisë. Edhe Serbia duhet të heqë dorë nga narrativa se Kosova nuk është shtet.” Marrëveshjet e mundshme për targarat e veturave, energjinë në veri të Kosovës dhe një proces më i lehtë për njohjen e diplomave mund të krijojnë momentum për një marrëveshje përfundimtare. Megjithatë, disa i konsideruan këto marrëveshje si çështje rrethore të parëndësishme për rrugën e dialogut. “Dialogu Kosovë-Serbi është një proces nga lart-poshtë dhe çështjet qendrore duhet të adresohen fillimisht.” Themelimi i Asociacionit/Bashkësisë së Komunave me Shumicë Serbe (ASM) dhe lejimi i Kosovës për të aplikuar me sukses për anëtarësim në organizatat ndërkombëtare do të lehtësonin mosmarrëveshjet ekzistuese Kosovë-Serbi dhe do të krijonin një hapësirë për një 'marrëveshje përfundimtare'.

BE dhe SHBA mund të sjellin momentum të ri në dialog. BE dhe SHBA duhet të aplikojnë qasjen “shkopinjë dhe karrota” dhe kjo mund të çojë në dy skenarë të mundshëm: Nëse Kosova e pengon procesin Serbia do të anëtarësohet në BE; “Nëse Serbia do të ishte pala penguese, Kosova do të anëtarësohej në NATO brenda dy viteve,” parashikoi një folës. Emërimi i një të dërguari special për Ballkanin Perëndimor nga Rusia dhe përfshirja e drejtpërdrejtë e Rusisë në dialog nuk u përjashtua si mundësi. Tensionet Rusi-Ukrainë ka shumë të ngjarë të kenë pasoja në rajon dhe të ndikojnë në ritmin e dialogut. Një folës argumentoi se fokusi eventual i shtuar i BE-së dhe SHBA-së në Evropën Lindore mund ta bëjë dialogun më pak të cënueshëm ndaj zhvillimeve të brendshme. Pjesëmarrës të tjerë argumentuan se zhvillimet në Ukrainë mund të mobilizojnë SHBA-në dhe BE-në për të përshpejtuar negociatat dhe për të përfunduar mosmarrëveshjen Kosovë-Serbi.

Dymbëdhjetë ide, katër grupe, një zgjidhje

Pjesëmarrësit u ndanë në katër grupe për të identifikuar interesat e përbashkëta të Kosovës dhe Serbisë. Lista e mëposhtme paraqet kombinim të rekomandimeve nga katër grupet.

- *Zbatimi i vendimit të gjykatës për Manastirin e Deçanit.* Shumë pjesëmarrës rekomanduan që vendimi i Gjykatës Kushtetuese të Kosovës të vitit 2016 për 24 hektarët të zbatohet pa vonesë.
- *Ofrimi i një zgjidhjeje pragmatike për energjinë elektrike në veri.* Banorët e katër komunave në veri ende nuk i paguajnë faturat e energjisë elektrike. Megjithëse negociatat në vazhdimësi po zhvillohen në Bruksel, nevojitet një zgjidhje e shpejtë për të shmangur një krizë tjetër të panevojshme. “Arritja e një marrëveshjeje për energjinë mund të prodhojë një kontekst më të mirë dhe të vendosë bazën për të dyja palët për të ecur përpara drejt marrëveshjes së madhe.”
- *Përmbajtja nga përdorimi i forcës dhe narrativave ‘nxitëse’.* Kishte konsensus se si Prishtina

ashtu edhe Beogradi e kanë moderuar gjuhën e tyre. Edhe pse kjo qasje mund të mos çojë në një marrëdhënie më të mirë Kosovë-Serbi 'per se', mund të jetë e dobishme për parandalimin e përshkallëzimeve eventuale.

- *Ridizajnimi i marrëveshjes për target e makinave.* Me skadimin e marrëveshjes së përkohshme, Kosova dhe Serbia duhet të gjejnë një zgjidhje që largon komplikimet aktuale.
- *Zbatimi i të gjitha marrëveshjeve të nënshkruara më parë.* Kishte pajtueshmëri që zbatimi i të gjitha marrëveshjeve të nënshkruara më parë mund të ndihmonte në ndërtimin e besimit të ndërsjellë. Megjithatë, shumë nuk ishin optimistë, veçanërisht për krijimin e ASM-së.
- *Personat e zhdukur.* Pjesëmarrësit u pajtuan që çështja e personave të pagjetur të trajtohet më urgjentisht dhe si çështje humanitare.
- *Organizimi i një ndeshjeje miqësore futbollit.* Shumë u pajtuan se organizimi i një ndeshjeje futbollit ndërmjet Kosovës dhe Serbisë do të mund të kontribonte në marrëdhëniet e mira në sport dhe të promovonte një praktikë të tillë të mirë në fusha të tjera.
- *Promovimi i bashkëpunimit më të mirë ekonomik.* Si Kosova ashtu edhe Serbia mbështesin bashkëpunimin ekonomik rajonal, por nuk pajtohen për çështjet që kanë të bëjnë me statusin. Ndërsa Prishtina insiston të përfaqësohet si një entitet i barabartë, Serbia rekomandon që statusi i Kosovës të trajtohet veçmas dhe të mos ndikojë në vendimin e kësaj të fundit për t'iu bashkuar nismave rajonale.
- *Thjeshtimi i procedurave për lëvizjen e lirë të njerëzve.* Ndërsa shumica e pjesëmarrësve rekomanduan thjeshtimin e mëtejshëm të lëvizjes së lirë të njerëzve, disa folës argumentuan se "për sa kohë që procesi aktual funksionon, nuk ka nevojë ta ndryshojmë atë." Megjithatë, shumë rekomanduan zgjidhjen e problemit në një të ardhme të afërt.
- *'Rivendosja' e moratoriumit të Uashingtonit.* Disa pjesëmarrës argumentuan se rivendosja e moratoriumit të Uashingtonit për aplikimet e Kosovës në organizatat ndërkombëtare dhe për fushatat e çnjohjeve të Serbisë mund të parandalojë përshkallëzimin e mëtejshëm. Të tjerët nuk u pajtuan.
- *Promovimi i Kosovës si shtëpi e sigurt për komunitetin serb.* Përderisa shumica dërrmuese e serbëve që u larguan nga Kosova pas luftës nuk ka gjasa të kthehen në shtëpitë e tyre, pjesëmarrësit rekomanduan që qeveria e Kosovës të promovojë kthimin e serbëve dhe të krijojë mekanizma për zgjidhjen e çështjeve të tyre pronësore.
- *Vendosja e bashkëpunimit në fushën e sigurisë.* Siguria dhe lufta kundër krimit të organizuar janë çështje përtej kufijve etnikë dhe gjeografikë. Beogradi dhe Prishtina mund të bashkëpunojnë në hetimin e vrasjes së Oliver Ivanoviçit.

Pjesëmarrësit mbështesin procesin e normalizimit ndërmjet Beogradit dhe Prishtinës me dialogun si platformë. Megjithatë, këndvështrimet e tyre se si duhet të duket marrëveshje, ndryshojnë. Në përfundim, pati konsensus që dialogu të vazhdojë, megjithëse nuk priten zhvillime të mëdha deri në gjysmën e dytë të vitit 2022. Trashëgimia e së kaluarës dhe personat e pagjetur mbeten çështje të ndjeshme. Qeveritë e Kosovës dhe Serbisë duhet të tregojnë konsistencë, jo rezistencë, ndaj dialogut. Të dyja palët duhet të kërkojnë kompromise dhe zgjidhje nga të cilat përfitojnë të dyja palët.

Pjesëmarrësit

Sipas rendit alfabetik anglez

Gresa Baftiu, Bashkëpunëtore në Kosovë, Këshilli për Qeverisje Përfshirëse
Saranda Bogujevci, Nënkryetare e Parlamentit, Parlamenti i Kosovës, Lëvizja Vetëvendosje
Gordana Comic, Ministre për të Drejtat e Njeriut dhe Minoriteteve dhe Dialogut Social e Serbisë, Ish-deputete e Parlamentit të Serbisë
Blerta Deliu Kodra, Anëtare e Parlamentit të Kosovës, Partia Demokratike e Kosovës
Arben Gashi, Anëtar i Parlamentit të Kosovës, Lidhja Demokratike e Kosovës
Shpetim Gashi, Nënkryetar, Këshilli për Qeverisje Përfshirëse
Ardian Gjini, Nënkryetar, Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës; Kryetar i Gjakovës; Ish-deputet i Parlamentit të Kosovës
Dukagjin Gorani, Analist; Ish-deputet i Parlamentit të Kosovës
Lutfi Haziri, Nënkryetar, Lidhja Demokratike e Kosovës; Ish-deputet i Parlamentit të Kosovës
Vincent Hug, Këshilltar për Sigurinë Njerëzore, Departamenti Federal i Punëve të Jashtme të Zvicrës
Doarsa Kica Xhelili, Anëtare e Parlamentit të Kosovës, Lëvizja Vetëvendosje
Mimoza Kusari-Lila, Anëtare e Parlamentit të Kosovës, Lëvizja Vetëvendosje
Agon Maliqi, Drejtor Ekzekutiv, S'bunker
Milivoje Mihajlovic, Analist
Petar Miletic, Analist; Ish-deputet i Parlamentit të Kosovës
Besian Mustafa, Anëtar i Parlamentit të Kosovës, Lidhja Demokratike e Kosovës
Igor Novakovic, Bashkëpunëtor në Serbi, Këshilli për Qeverisje Përfshirëse
Zoran Ostojic, Gazetar; Ish-deputet i Parlamentit të Serbisë
Zenun Pajaziti, Anëtar i Kryesisë, Partia Demokratike e Kosovës; Ish-deputet i Parlamentit të Kosovës
Snezana Paunovic, Anëtare e Parlamentit të Serbisë, Partia Socialiste e Serbisë
Alex Roinishvili Grigorev, President, Këshilli për Qeverisje Përfshirëse
Dragan Sormaz, Anëtar i Parlamentit të Serbisë, Partia Progresive Serbe
Christoph Spaeti, Zyrtar i Programit të Kaukazit dhe Ballkanit Perëndimor, Divizioni i Paqes dhe të Drejtave të Njeriut, Departamenti Federal i Punëve të Jashtme të Zvicrës
Nemanja Starovic, Sekretar i Shtetit, Ministria e Punëve të Jashtme e Serbisë
Visar Ymeri, Drejtor Ekzekutiv, Instituti për Politika Sociale “Musine Kokolari”; Ish-deputet i Parlamentit të Kosovës